VENDIM
Nr. 185, datë 12.9.2024

MBI FILLIMIN E PROCEDURËS LIDHUR ME SHQYRTIMIN E KËRKESËS SË SHOQËRISË "SAMASOL" SHPK PËR LICENCIM NË VEPRIMTARINË E PRODHIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE

Në mbështetje të neneve 16 dhe 37, pika 2, germa "a", të ligjit nr. 43/2015, "Për sektorin e energjisë elektrike", i ndryshuar; neneve 4, pika 1, germa "a", 5, pika 1, germa "a", dhe 10, pikat 1 dhe 3, të "Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin, njohjen dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike", të miratuar me vendimin e Bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) nr. 109, datë 29.6.2016, e ndryshuar; si dhe neneve 15 dhe 19, pika 1, germa "a" të "Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s", miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.6.2016; Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 12.9.2024, mbasi shqyrtoi relacionin me nr. 1854/1 prot., datë 9.9.2024, të Drejtorisë së Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes "Mbi kërkesën e shoqërisë 'Samasol' sh.p.k. për licencim në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike",

konstatoi se:

- Shoqëria "Samasol" sh.p.k., me shkresën e protokolluar në ERE me nr. 1854 prot., datë 2.9.2024, ka paraqitur kërkesën për licencim në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga centrali fotovoltaik me kapacitet prodhues 2 mw, në fshatin Grykë, Njësia Administrative Topojë Bashkia Fier, qarku Fier.

- Nga shqyrtimi i aplikimit, në referencë të përcaktimeve të "Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin, njohjen dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike", të ndryshuar, rezulton se shoqëria ka kryer pagesën e aplikimit sipas përcaktimeve të aneksit A dhe ka plotësuar dokumentacionin e kërkuar në zbatim të nenit 9 për pikën 1.1, germat "a" "b" dhe "c"; për pikën 1.2, germat "a", "b", "c", "d" dhe "f" ; për pikën 1.3 germat "a" dhe "c"; për pikën 2.1 germat "a", "b", "c", "d", "e" dhe "f".

- Rezulton se shoqëria "Samasol" sh.p.k.:

- ka nënshkruar me Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë (MIE) kontratën nr. 10517 rep., nr. 4879 kol., datë 28.12.2023;

- ka marrë miratimin për lidhjen e centralit fotovoltaik me rrjetin e shpërndarjes nëpërmjet shkresë së shoqërisë Operatori i Sistemit të Shpërndarjes (OSSH) sh.a., nr. 7252/3 prot., datë 10.10.2022;

- është pajisur me vendim për VNM paraprake, lëshuar më datë 21.10.2022, nga Agjencia Kombëtare e Mjedisit (AKM), për të ndërtuar impiantin fotovoltaik me fuqi 2 mw. Rezulton se VNM-ja paraprake është e vlefshme deri më datë 21.10.2024.

- Nga ky aplikim nevojitet të plotësohet informacioni/dokumentacioni në vijim:

Neni 9

Pika 1. Dokumentacioni i përgjithshëm për të gjitha aplikimet për pajisje me licencë

Pika 1.3

- **germa "b":** Të depozitohet në ERE njoftimi përkatës drejtuar MIE-s në lidhje ndryshimin e vlerës së investimit dhe qëndrimi i saj, ose amendimi i kontratës së lidhur me Autoritetin Kontraktor në rast se ka një të tillë. Po ashtu, duhet të dokumentohet mbulimi i 20% të vlerës së investimit.

Pika 2, Dokumentacioni specifik sipas tipit të licencës

Pika 2.1

- **germa "e":** Të depozitohet në ERE informacion/dokumentacion në lidhje me fillimin e punimeve. Nëse shoqëria nuk ka filluar ende punimet e ndërtimit, duhet të depozitojë në ERE një VNM të re.

Për gjithë sa më sipër, Bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Të fillojë procedurën për licencimin e shoqërisë "Samasol" sh.p.k. në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga centrali fotovoltaik me kapacitet prodhues 2 mw, në fshatin Grykë, Njësia Administrative Topojë Bashkia Fier, qarku Fier.

2. Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes të njoftojë shoqërinë "Samasol" sh.p.k. dhe Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Çdo palë e përfshirë në këtë procedurë mund t'i kërkojë ERE-s, brenda 7 ditëve kalendarike nga data e marrjes së vendimit, rishikimin e vendimit të Bordit në rast se ka siguruar prova të reja që mund ta çojnë Bordin në marrjen e një vendimi të ndryshëm nga i mëparshmi apo për gabime materiale të konstatuara. Për këtë vendim mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Petrit Ahmeti